<p>duhet t'i kalojë 200 ditë. Kohëzgjatja e një mase mbrojtëse të përkohshme llogaritet si pjesë e periudhës totale të zbatimit të masave mbrojtëse.</p>	<p>shall not exceed 200 days. The duration of a provisional safeguard measure shall be calculated as part of the total period of application of safeguard measures.</p>	<p>prelaziti 200 dana. Trajanje privremene zaštitne mere se obračunava kao deo ukupnog perioda primene zaštitnih mera.</p>
<p>5. Produkti i cili është objekt i një mase të përkohshme mbrojtëse mund të importohet në territorin e Republikës së Kosovës për qarkullim të lirë pas pagimit të detyrimeve të përkohshme mbrojtëse të vendosura me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, apo pas dhënies së garancionit apo garantimit tjetër ekuivalent të pagesës.</p>	<p>5. The product which is the subject of a provisional safeguard measure may be imported into the territory of the Republic of Kosovo for free circulation after the payment of provisional safeguard duties imposed by the decision of the Government of the Republic of Kosovo, or after giving of the warranty or other equivalent payment guarantee.</p>	<p>5. Proizvod koji je predmet privremene zaštitne mere mož biti uvezen na teritoriji Republike Kosova za slobodan promet nakon isplate privremenih zaštitnih obaveza nametnutih odlukom Vlade Republike Kosova, ili nakon davanja garancije ili druge ekvivalentne garancije plaćanja.</p>
<p>6. Ministria duhet të vazhdojë hetimin gjatë zbatimit të masës së përkohshme mbrojtëse në mënyrë që të përcaktojë nevojën për zbatimin e mëtejshëm të masës mbrojtëse.</p>	<p>6. The Ministry shall continue the investigation during the application of the provisional safeguard measures in order to determine the need for further application of the safeguard measure.</p>	<p>6. Ministarstvo treba da nastavi istragu tokom primene privremenih zaštitnih mera kako bi se utvrdila potreba za dalju primenu zaštitnih mera.</p>
<p>7. Në qoftë se pas hetimeve të mëtejshme, Ministria arrin në përfundim që rritja e importeve të produktit të hetuar në territorin e Republikës së Kosovës nuk shkakton ose nuk kërcënon të shkaktojë dëm serioz prodhuesit vendor, shumat e paguara si detyrime të përkohshme mbrojtëse gjatë kohës së zbatimit të masës së përkohshme mbrojtëse do t'u kthehen paguesve brenda tridhjetë (30) ditëve pas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.</p>	<p>7. If after further investigation, the Ministry concludes that increased imports of the product investigated in the territory of Kosovo does not cause or threaten to cause serious injury to domestic producers, the amounts paid as provisional safeguard duties during application the provisional safeguard measure will be returned to the payers within a thirty (30) days after the decision of the Government of the Republic of Kosovo.</p>	<p>7. Ako nakon dalje istrage, Ministarstvo dođe do zaključka da povećanje uvoza istraženog proizvoda na teritoriji Republike Kosova ne prouzrokuje ili ne preti da prouzrokuje ozbiljnu štetu domaćim proizvođačima, iznosi koji su isplaćeni kao privremena obaveza zaštite tokom implementacije privremenih zaštitnih mera, biće vraćeni obveznicima u roku od trideset (30) dana nakon odluke Vlade Republike Kosova.</p>
<p>8. Në qoftë se, pas hetimeve të mëtejshme, Ministria arrin në përfundim që rritja e importeve të produktit të hetuar në territorin e Republikës së Kosovës shkakton ose kërcënon të shkaktojë dëm</p>	<p>8. If, after further investigation, the Ministry concludes that increased imports of the product investigated in the territory of Kosovo causes or threatens to cause serious injury to domestic</p>	<p>8. Ako se nakon dalje istrage, Ministarstvo dođe do zaključka da povećanje uvoza istraženog proizvoda na teritoriji Republike Kosova prouzrokuje ili preti da prouzrokuje</p>

<p>serioz prodhuesit vendor, shumat e paguara si detyrime të përkohshme mbrojtëse gjatë kohës së zbatimit të masës së përkohshme mbrojtëse shndërrohen menjëherë në statusin e detyrimeve mbrojtëse.</p>	<p>producers, the amounts paid as provisional safeguard duties during the application of provisional measure shall immediately be changed to the status of safeguard duties.</p>	<p>ozbiljnu štetu domačim proizvođačima, iznosi koji su isplaćeni kao privremene obaveze zaštite tokom implementacije privremenih zaštitnih mera treba odmah da se pretvore u statusu zaštitnih obaveza.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 Masat mbrojtëse përfundimtare</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Definitive safeguard measures</p>	<p style="text-align: center;">Član 19 Konačne zaštitne mere</p>
<p>1. Nëse Ministria pas një hetimi të kryer sipas dispozitave të këtij ligji, konstaton se produkti i hetuar është duke u importuar në territorin e Republikës së Kosovës në sasi të rritur dhe në kushte të tilla që shkakton ose kërcënojë t'i shkaktojë dëm serioz ndaj prodhuesit, Ministria publikon njoftim publik në Gazetën Zyrtare për zbatimin e masës mbrojtëse përfundimtare.</p> <p>2. Kur vendoset marrja e një mase mbrojtëse përfundimtare, merren parasysh:</p> <p>2.1. kostot ekonomike dhe sociale, afatshkurtra dhe afatmesme si pasojë e zbatimit të masës;</p> <p>2.2. kostoja e mos-zbatimit të masës mbrojtëse;</p> <p>2.3. ndikimi i masës mbrojtëse në konsumatorë dhe në konkurrencën në tregun vendor.</p> <p>3. Masa mbrojtëse përfundimtare zbatohet për kohën e nevojshme për të parandaluar ose rregulluar dëmin e shkaktuar industrisë vendore dhe për t'i lehtësuar asaj përshtatjen me tregun.</p>	<p>1. If the Ministry, after the investigation conducted pursuant to the provisions of this Law, concludes that the investigated product is being imported into the territory of the Republic of Kosovo in such increased quantities and under such conditions that cause or threaten to cause serious injury to the producer, the Ministry shall publish on the Official Gazette its decision on the application of a safeguard measure.</p> <p>2. When the final decision is made on final imposition of safeguard measures the following shall be taken into account:</p> <p>2.1. medium and long-term economic and social costs as a result of application of the measure;</p> <p>2.2. cost of the non-application of the safeguard measure;</p> <p>2.3. impact of the safeguard measure on consumers and domestic market competition.</p> <p>3. Definitive safeguard measures shall be applied for the time necessary to prevent or remedy the injury caused to domestic industry and to facilitate the adaptation with the market.</p>	<p>1. Ako posle istrage koja je sprovedena u skladu sa odredbama ovog zakona Ministarstvo, utvrdi da se istražen proizvod uvozi na teritoriji Republike Kosova u povećanim količinama i pod takvim uslovima da prouzrokuje ili preti da prouzrokuje ozbiljnu štetu proizvođačima, Ministarstvo objavljuje javni oglas u Službenom Listu za sprovođenje konačne mere zaštite.</p> <p>2. Kada se uspostavlja konačna zaštitna mera, uzima se u obzir:</p> <p>2.1. srednjoročni i dugoročni ekonomski i socijalni troškovi kao rezultat primene mere;</p> <p>2.2. cena nesprovođenja zaštitne mere;</p> <p>2.3. uticaj zaštitnih mera na potrošače i na konkurentnost na domačem tržištu.</p> <p>3. Konačne zaštitne mere primenjuju se za potrebno vreme da se spreči ili ispravi prouzrokovana šteta domaćoj industriji i da se olakša usvajanje domaćih proizvođača.</p>

<p>Masat mbrojtëse marrin formën e:</p> <p>3.1 vlerës doganore shtesë; 3.2 kufizimeve sasiore të importeve;</p> <p>3.2.1 Në rastet e vendosjes së një kufizimi sasior mbi importet, si një masë mbrojtëse, merren parasysh, veçanërisht:</p> <p>3.2.1.1 shkëmbimet tregtare; 3.2.1.2 vëllimi i produkteve të eksportuara në Republikën e Kosovës, sipas kontratave të përfunduara para hyrjes në fuqi të masës mbrojtëse; 3.2.1.3 ndikimi i anës negative të vendosjes së një kufizimi sasior mbi importet.</p> <p>4. Kufizimet sasiore, të parashikuara në nën-paragrafin 3.2 të paragrafit 3, nuk mund të jenë më të ulëta se niveli mesatar i importeve në tri vitet e fundit, për të cilat ka statistika, për sa kohë që nuk është i nevojshëm një nivel tjetër, për të parandaluar apo rregulluar dëmin serioz, që i është shkaktuar industrisë vendore.</p> <p>5. Për zbatimin e një mase mbrojtëse duhet të përcaktohen:</p> <p>5.1. produkti i cili është objekt i masës dhe kodi i tij tarifor; 5.2. periudha fillestare për zbatimin e masës mbrojtëse; 5.3. skema për një liberalizim progresiv të masës;</p>	<p>Safeguard measures take the form of:</p> <p>3.1 additional customs value; 3.2 import volume restrictions;</p> <p>3.2.1 Where restrictions on import volumes are applied as a safeguard measure, the following shall be particularly taken into account: 3.2.1.1 trade exchanges; 3.2.1.2 volume of products exported to the Republic of Kosovo, according to contracts concluded before the entry into force of a safeguard measure; 3.2.1.3 the impact of the adverse side of imposing a quantity restriction on imports.</p> <p>4. Quantity restrictions, as provided in subparagraph 3.2 of paragraph 3 may not be lower than the average level of imports in the last three years for which there are statistics, as long as another level is not necessary, to prevent or remedy the serious injury caused to the domestic industry.</p> <p>5. In order to apply a safeguard measure, the following shall be determined:</p> <p>5.1. the product which is subject of the measure and its tariff code; 5.2. the initial period for the application of safeguard measure; 5.3. the scheme for a progressive liberalization of the measure;</p>	<p>Zaštitne mere uzimaju oblik:</p> <p>3.1 dodatne carinske vrednosti; 3.2 kvantitativne restrikcije uvoza;</p> <p>3.2.1 U slučajevima uspostavljanja kvantitativnih restrikcija uvoza, kao zaštitne mere, uzimaju se u obzir, naročito:</p> <p>3.2.1.1 trgovinske razmene; 3.2.1.2 obim izvozenih proizvoda u Republici Kosovo, po osnovu ugovora zaključenih pre stupanja na snagu zaštitne mere; 3.2.1.3 uticaj negativne strane postavljenja kvantitativne restrikcije uvoza.</p> <p>4. Kvantitativne restrikcije, kao što je predviđeno u tački 3.2 stava 3 ne može biti niža od prosečnog nivoa uvoza u poslednje tri godine za koje postoje statistike, sve dok nije potrebn drugi nivo, da spreči ili otkloni ozbiljnu štetu, koja je naneta domaćoj industriji.</p> <p>5. Za primenu zaštitne mere treba odrediti:</p> <p>5.1. proizvod koji je predmet mere i njegov tarifni broj; 5.2. početni period za sprovođenje zaštitne mere; 5.3. šema za progresivnu liberalizaciju mere;</p>
--	--	--

<p>5.4. kushtet për zbatimin e masës mbrojtëse; dhe 5.5. baza për zbatimin e masës mbrojtëse.</p> <p>6. Lejimi i produkteve për qarkullim të lirë në territorin e Republikës së Kosovës mund të lejohet vetëm pas pagesës së detyrimeve mbrojtëse.</p> <p>7. Shqiptimi i masave mbrojtëse nuk do të parandalojë lejimin e produkteve, në territorin e Republikës së Kosovës, të cilat janë eksportuar apo do të eksportohen në Republikën e Kosovës sipas kushteve dhe afateve të një kontrate e cila formalisht është bërë para datës së shqiptimit të detyrimeve mbrojtëse.</p> <p>8. Kur shuma e masës mbrojtëse përfundimtare është më e vogël se shuma e masës mbrojtëse të përkohshme, diferenca kthehet, ndërsa kur shuma e masës mbrojtëse përfundimtare është më e madhe se shuma e masës mbrojtëse të përkohshme, diferenca mbledhet.</p> <p>9. Nëse Ministria në bashkëpunim me komisionin vendos se nuk është i nevojshëm zbatimi i masave mbrojtëse përfundimtare, masa mbrojtëse e përkohshme shfuqizohet dhe shuma e mbledhur më parë, si rezultat i masave mbrojtëse të përkohshme, kthehet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kthimin e taksave doganore.</p>	<p>5.4. conditions for application of safeguard measure, and 5.5. the grounds for application of safeguard measures.</p> <p>6. The release of products for free circulation in the territory of Kosovo can be granted only after payment of safeguard duties.</p> <p>7. The imposition of safeguard measures will not prevent products, in the territory of Kosovo, which were exported or will be exported to the Republic of Kosovo under the terms and conditions of a contract which was formally made before the date of imposition of safeguard duties.</p> <p>8. When the amounts of the definitive safeguard measure is less than the amount of the provisional safeguard measure, the difference shall be returned, whereas where the amount of the definitive safeguard measure is greater than the amount of the provisional safeguard measure, the difference is collected.</p> <p>9. If the Ministry in cooperation with the Commission decides that implementation of definitive safeguard measures is not necessary, the provisional safeguard measures shall be repealed and the amount collected earlier as a result of provisional safeguard measures shall be returned in accordance with the provisions of legislation on refund of customs duties.</p>	<p>5.4. uslovi za sprovođenje zaštitne mere; i 5.5. osnov za sprovođenje zaštitne mere.</p> <p>6. Dozvoljavanje proizvoda za slobodno kretanje na teritoriji Republike Kosova može se odobriti samo nakon uplate zaštitnih obaveza</p> <p>7. Izricanje zaštitnih mera neće sprečiti dozvolu proizvoda na teritoriji Republike Kosova, koje se izvoze ili su izvezeni u Republici Kosovo, pod uslovima i okvirima ugovora koji je formalno donet pre izricanja zaštitnih obaveza.</p> <p>8. Kada iznos konačne zaštitne mere je manji od iznosa privremene mere, razlika se vraća, dok je iznos konačne zaštitne mere veći od iznosa privremene mere, razlika se sakuplja.</p> <p>9. Ako Ministarstvo u saradnji sa Komisijom odluči da nije potrebno da se sprovedu konačne zaštitne mere, privremena zaštitna mera će se ukinuti, a prethodno prikupljeni iznos, kao rezultat privremenih zaštitnih mera, se vraća u skladu sa odredbama zakona o povratku carine.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 20 Kohëzgjatja e masave mbrojtëse</p>	<p style="text-align: center;">Article 20 The Duration of a Safeguard Measure</p>	<p style="text-align: center;">Član 20 Trajanje zaštitnih mera</p>
<p>1. Kohëzgjatja e një mase mbrojtëse fillestare nuk duhet t'i kalojë katër (4) vite përfshirë kohëzgjatjen e masës mbrojtëse të përkohshme sipas nenit 18 paragrafi 4 të këtij ligji nëse nuk ka pas efekt të parandalimit të dëmit ose kërcënimit për dëm.</p> <p>2. Periudha e përmendur mund të zgjatet nëse Ministria përcakton me anë të hetimeve të mëvonshme të kryera sipas dispozitave të këtij ligji, se zbatimi i masës mbrojtëse vazhdon të jetë i nevojshëm për të parandaluar ose korrigjuar dëmin serioz dhe nëse ka dëshmi se gjendja sa i përket prodhimit të së prodhuesit ose kushtet ekonomike janë duke u përmirësuar si pasojë e zbatimit të masës mbrojtëse.</p> <p>3. Hetimi në lidhje me zgjatjen e periudhës së masës mbrojtëse do të iniciohet së paku nëntëdhjetë (90) ditë para fundit të periudhës të zbatimit të masës fillestare mbrojtëse që është duke u zbatuar.</p> <p>4. Kohëzgjatja e përgjithshme e një mase mbrojtëse përfshirë edhe kohëzgjatjen e masës së përkohshme dhe kohëzgjatjet e masave fillestare dhe zgjatjet e tyre nuk duhet t'i tejkalojë tetë (8) vite.</p> <p>5. Zgjatja e periudhës së masës mbrojtëse duhet të mbulojë produktet e njëjta në të cilat është zbatuar masa mbrojtëse fillestare. Kushtet e masave</p>	<p>1. The duration of an initial safeguard measure shall not exceed four (4) years, including duration of the provisional safeguard measure based to Article 18, paragraph 4 of present law, if there is no after affect of preventing the damage or threat of harm.</p> <p>2. The mentioned period can be extended, if the Ministry determines through latter investigations, conducted according to the provisions of this Law, that the application of the safeguard measure continues to be necessary to prevent or remedy serious injury, and if there is evidence that the situation with respect to the producer' productivity or economic conditions are improving due to the application of the safeguard measure.</p> <p>3. The investigation with respect to the extension of the period of the safeguard measure shall be initiated at ninety (90) days before the end of the period of the initial measure already being applied.</p> <p>4. The total duration of a safeguard measure (including the duration of the provisional measure and the durations of the initial and extended measures) shall not exceed 8 years.</p> <p>5. Extension of the period of a safeguard measure shall cover the same products, on which the initial safeguard measure was applied. The</p>	<p>1. Trajanje početne zaštitne mere, ne treba da prelazi četiri (4) godine uključujući i trajanje privremene zaštitne mere, u skladu sa članom 18. stav 4 ovog zakona ako nije bilo efekta na sprečavanje oštećenja ili pretnje za oštećenje.</p> <p>2. Pomenuti period može biti produžen ako Ministarstvo kroz poslednja istraživanja sprovedenih u skladu sa odredbama ovog zakona utvrdi, da je primena zaštitnih mera i dalje neophodna radi sprečavanja ili otklanjanja ozbiljne štete i ako postoje dokazi da se situacija u vezi sa proizvodnjom proizvođača ili ekonomskim uslovima poboljšava kao rezultat primene zaštitne mere.</p> <p>3. Istraga o produženju perioda zaštitne mere će biti pokrenuta najmanje devedeset (90) dana pre isteka perioda primene početne zaštitne mere koja se sprovodi.</p> <p>4. Ukupno trajanje zaštitne mere (uključujući i trajanje privremenih mera i trajanje početnih mera i njihovo produženje) ne bi trebalo da prelazi osam (8) godina.</p> <p>5. Produženje perioda zaštitne mere treba da obuhvata iste proizvode za koje se sprovode početne zaštitne mere. Uslovi produženih</p>

<p>mbrojtëse të zgjatura nuk duhet të jenë më kufizuese se ato në fund të periudhës së zbatimit të masës mbrojtëse fillestare.</p> <p>6. Kur kohëzgjatja e zbatimit të një mase kalon një vit, masa liberalizohet progresivisht, me intervale të vazhdueshme, gjatë periudhës së zbatimit, ndërsa kur kalon 3 vjet, atëherë do të rishikohet situata jo më vonë se gjysma e kohëzgjatjes së zbatimit të masës, në mënyrë që të përcaktohet nëse është ende i nevojshëm zbatimi i saj apo rritja e ritmit të liberalizimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Rishikimi i masave mbrojtëse</p>	<p>conditions of the extended safeguard measure shall not be more restrictive than those at the end of the period of application of the initial measure.</p> <p>6. If the duration of a safeguard measure exceeds one year, the measure shall be liberalised progressively, with constant intervals during the application period, while when it exceeds 3 years, then the situation shall be reviewed no later than half length of the application of the measure, in order to determine whether it is still necessary to apply or increase the pace of liberalization.</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Review of Safeguard Measures</p>	<p>zaštitnih mera ne treba da budu restriktivniji od onih na kraju perioda primene početne zaštitne mere.</p> <p>6. Kada trajanje primene zaštitne mere prelazi jednu godinu, mera će biti periodično liberalizovana, sa stalnim intervalima u toku perioda primene, a kada prođu 3 godine, onda situacija će biti pregledana ne kasnije od polovine trajanja implementacije mere, kako bi se utvrdilo da li i dalje je potrebno da se sprovede ili povećati ritam liberalizacije.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Revizija zaštitnih mera</p>
<p>1. Kur kohëzgjatja e zbatimit të masave mbrojtëse kalon tre (3) vite, Ministria në bashkëpunim me Komisionin duhet jo më vonë se në mes të kësaj periudhe, të kryejë një rishikim të gjendjes aktuale, veçanërisht sa i përket efekteve të masës mbrojtëse te prodhuesit. Ministria duhet përmes rishikimit, të përcaktojë nevojën për vazhdimin apo pushimin e zbatimit të masës mbrojtëse, apo modifikimit të kushteve të zbatimit të saj.</p> <p>2. Qeveria e Republikës së Kosovës merr vendim për të proceduar zbatimin e masës ose për ta tërhequr masën.</p> <p>3. Ministria duhet të publikojë një njoftim publik në Gazetën Zyrtare për rezultatet e rishikimit dhe</p>	<p>1. When the duration of applied safeguard measure is more than three (3) years, the Ministry in collaboration with the Commission shall, not later than the mid- term of period, conduct a review of the current situation, particularly, with the effects of the safeguard measure to producers. Ministry shall, through the review determine the necessity of continuing or ceasing the application of the safeguard measure, or modifying the conditions of its application.</p> <p>2. The Government of the Republic of Kosovo takes decision to precede measure application or to draw the measure.</p> <p>3. The Ministry shall issue a public notice in the Official Gazette for results of the review and the</p>	<p>1. Kada trajanje primene zaštitnih mera je više od tri (3) godine, Ministarstvo u saradnji sa Komisijom treba da, najkasnije sredinom ovog perioda, izvrši reviziju trenutne situacije, naročito efekte zaštitnih mera proizvođača. Ministarstvo treba da kroz reviziju, utvrdi potrebu za nastavak ili ukidanje primene zaštitnih mera, ili izmenu uslova njegove primene.</p> <p>2. Vlada Republike Kosova donosi odluku za procesuiranje primene ili za povlačenja mere.</p> <p>3. Ministarstvo treba da objavi javno obaveštenje u Službenom Listu o rezultatima</p>

<p>për konstatimet dhe vendimet e dala nga kjo.</p> <p>4. Hetimet rreth shqyrtimit duhet të kryhen sipas procedurës hetimore të vendosur në këtë ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Zbatimi i sërishëm i një mase mbrojtëse</p> <p>1. Zbatimi i një masë mbrojtëse mund të përsëritet sërish në importin e një produkti të caktuar, vetëm një (1) vit pas skadimit të masës mbrojtëse të zbatuar.</p> <p>2. Sipas dispozitës së paragrafit 1 të këtij neni kur kohëzgjatja e masës mbrojtëse të zbatuar nuk i tejkalon njëqind e tetëdhjetë (180) ditë, një masë mbrojtëse me kohëzgjatje prej apo më pak se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë mund të zbatohet sërish ndaj importit të një produkti të caktuar, nëse:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. ka kaluar së paku një (1) vit që nga data e paraqitjes së një mase mbrojtëse për importin e këtij produkti, dhe</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. masat mbrojtëse nuk janë zbatuar ndaj produktit të njëjtë më shumë se dy herë në periudhën pesë-vjeçare duke procesuar menjëherë datën e zbatimit të sërishëm të masës.</p>	<p>findings and decisions arising therefrom.</p> <p>4. Investigations for review shall be carried out according to the procedure of investigations established by this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Reapplication of a Safeguard Measure</p> <p>1. A safeguard measure may be reapplied on the import of a given product, only after one (1) year of expiration of the applied safeguard measure.</p> <p>2 According to the provision of the paragraph 1 of this Article, where the duration of the applied safeguard measure does not exceed hundred and eighty (180) days, a safeguard measure with duration of hundred and eighty (180) days or less may be reapplied to the import of a given product if:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. At least one year has elapsed since the date of introduction of a safeguard measure on the import of that product, and</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Safeguard measures have not been applied on the same product more than twice in the five-year period immediately proceeding the date of reapplication of the measure.</p>	<p>revizije i o zaključcima i odlukama koje proizilaze iz ovoga.</p> <p>4. Istrage oko revizije treba da se vode u skladu sa istražnim postupkom utvrđenim ovim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Ponovna primena zaštitne mere</p> <p>1. Primena zaštitne mere može se ponoviti na uvoz određenog proizvoda, samo jednu (1) godinu nakon isteka primenjene zaštitne mere.</p> <p>2. Prema odredbama stava 1 ovog člana, gde trajanje primene zaštitne mere ne prelazi sto osamdeset (180) dana, zaštitne mere sa ili manje od sto osamdeset (180) dana trajanja može se ponovo primeniti na uvoz određenog proizvoda, ako:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1 prošlo najmanje jedna (1) godina od dana podnošenja zaštitne mere na uvoz ovog proizvoda, i</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. zaštitne mere se nisu primenile na isti proizvod više od dva puta u petogodišnjem periodu obrađujući odmah datum ponovne implementacije mere.</p>
--	--	--

<p align="center">Neni 23 Dosja publike dhe e drejta për informim</p>	<p align="center">Article 23 Public file and the right to information</p>	<p align="center">Član 23 Javni dosije i pravo na informisanje</p>
<p>1. Ministria do të hap për secilin hetim nga një dosje publike ku do të vendosen të gjitha konstatimet, vendimet, njoftimet, protokollet dhe konsultimet, argumentet e shkruara të dorëzuara në Ministri, që kanë të bëjnë me çështjen dhe çdo dokument tjetër të cilin Ministria e konsideron të përshtatshëm për njoftim publik.</p> <p>2. Për ruajtjen e informatave të besueshme, kohë pas kohe në dosje duhet të përfshihen:</p> <p>2.1. të gjitha raportet publike të lidhura me një hetim apo rishikim;</p> <p>2.2. të gjitha materialet, përfshirë pyetësorët, formularët, përgjigjet dhe njoftimet me shkrim të paraqitura në Ministri;</p> <p>2.3. të gjitha informacionet tjera të formuluar apo të marra nga Ministria, përfshirë raportet e verifikimeve të kryera, dhe</p> <p>2.4. dokumentet tjera të cilat konsiderohet se janë konfidenciale për t'u publikuar.</p> <p>3. Materialet e dosjes publike përpos në të dhënat konfidenciale duhet të jenë në dispozicion të publikut të përgjithshëm, për t'u njohur me to dhe për kopjim.</p>	<p>1. The Ministry shall establish a public file on each investigation, where shall be placed all the conclusions, decisions, notifications, protocols of consultations, written arguments submitted to the Ministry that are relevant to the matter, and any other document which the Ministry, considers appropriate for public disclosure.</p> <p>2. Regarding the requirement to keep confidential information, from time to time the file shall include:</p> <p>2.1. all public reports relating to an investigation or review;</p> <p>2.2. all materials, including questionnaires, written responses and notifications submitted to the Ministry;</p> <p>2.3. all other information drafted or obtained by the Ministry, including reports of verifications conducted, and</p> <p>2.4. other documents which are deemed to be confidential for publication.</p> <p>3. Materials of the public file, except for confidential cases, shall be available for the general public for acknowledgement and copying.</p>	<p>1. Ministarstvo, otvara za svaku istragu javni dosije, gde se uvrštavaju sve konstatacije, odluke, obaveštenja, protokoli i konsultacije, argumenti u pisanoj formi dostavljeni Ministarstvu, koja se odnose na pitanje i svaki drugi dokument, koji Ministarstvo smatra podobnim za javno obaveštenje.</p> <p>2. Za čuvanje poverljivih informacija, povremeno u dosje treba da se obuhvate:</p> <p>2.1. svi javni izveštaji u vezi istrage ili preispitivanja;</p> <p>2.2. svi materijali, uključujući i upitnike, formulare, odgovore i pismena obaveštenja, podneta Ministarstvu;</p> <p>2.3. sve druge informacije, formulisane ili dobijene od Ministarstva, uključujući izveštaje izvršenih provera, i</p> <p>2.4. druga dokumenta, koji se smatraju da su poverljivi za objavljivanje.</p> <p>3. Materijali javnog dosijea, osim poverljivih podataka, treba da budu dostupni široj javnosti, u cilju informisanja i kopiranje.</p>

<p align="center">Neni 24 Ruajtja e konfidencialitetit</p>	<p align="center">Article 24 Preservation of Confidentiality</p>	<p align="center">Član 24 Čuvanje tajnosti</p>
<p>1. Çdo informacion i cili është i natyrës konfidenciale ose është ofruar në mënyrë konfidenciale, në rast se tregohet shkaku duhet të trajtohet si i tillë nga Ministria.</p> <p>2. Informacioni i tillë nuk do të bëhet publik pa lejen e palës dorëzuese.</p> <p>3. Të dhënat trajtohen konfidenciale kur:</p> <p>3.1 bërja publike e tyre ka efekte të pafavorshme për personin që i jep, ose për personin nga i cili janë marrë këto të dhëna;</p> <p>3.2 palët kanë argumentuar se i kanë siguruar në bazë konfidencialiteti.</p> <p>4. Palët e interesuara, që kanë siguruar të dhënat konfidenciale, duhet të japin një përmbledhje me hollësi për këto të dhëna, pa cënuar konfidencialitetin, të mjaftueshme për të kuptuar thelbin e informacionit të dhënë si konfidencial. Për raste të veçanta, palët mund të shpjegojnë se për të tilla informacione nuk mund të paraqitet përmbledhje, duke dhënë edhe arsyet me shkrim.</p> <p>5. Të dhënat nuk trajtohen konfidenciale kur:</p> <p>5.1 një kërkesë për konfidencialitet nuk është e justifikuar;</p> <p>5.2 edhe pse dhënësi nuk autorizon zbulimin e të</p>	<p>1. Any information which is by nature confidential or is provided on a confidential basis, if the cause is indicated, shall be treated as such by the Ministry.</p> <p>2. Such information will not be made public without the consent of the submitting party.</p> <p>3. Data is treated as confidential when:</p> <p>3.1 making them public has unfavourable effects for the person who submitted them or the person from whom such data is received;</p> <p>3.2 parties prove that they have obtained the data on a confidential basis.</p> <p>4. Interested parties, who have provided confidential information, should provide a detailed summary of this data, without violating confidentiality, sufficient to understand the essence of the information provided as confidential. For special occasions, parties can explain that such information may not be summarized by providing written justification.</p> <p>5. Data is not treated as confidential when:</p> <p>5.1 a request for confidentiality is not justified;</p> <p>5.2 although the provider does not authorize the disclosure of data in any form, they are verified</p>	<p>1. Svaka informacija koja je po svojoj prirodi povjerljiva ili je obezbeđena na poverljiv način, ako je naveden uzrok treba se tretirati kao takva od strane Ministarstva.</p> <p>2. Takve informacije neće biti javne, bez saglasnosti podnosioca.</p> <p>3. Podaci se smatraju kao poverljivi kada:</p> <p>3.1 čineći ih javnim ima nepovoljne efekte za osobu koja ih daje ili za osobu od koje su primljeni takvi podaci;</p> <p>3.2 stranke dokazuju da su dobili podatke na osnovu poverljivosti.</p> <p>4. zainteresovane strane, koje su obezbedile poverljive informacije treba obezbediti detaljan pregled ovih podataka, bez narušavanja poverljivosti, dovoljno da se shvati suština informacije obezbeđena kao poverljiva. U određenim slučajevima, stranke mogu objasniti da se takve informacije ne mogu sažeti, obezbeđujući pisano obrazloženje.</p> <p>5. Podaci se smatraju kao poverljivi kada:</p> <p>5.1 zahtev za poverljivost nije opravdan;</p> <p>5.2 iako davaoc ne odobrava objavljivanje podataka u bilo kom obliku, oni se</p>

<p>dhënave, në çfarëdolloj forme, ato verifikohen nga burime të tjera të besueshme.</p> <p>6. Dispozitat e mësipërme nuk pengojnë ministrinë dhe komisionin t'i përdorë të dhënat e përmendura në pikat e mësipërme të këtij neni, si referencë nese ju nevojitet për informacionin e përgjithshëm.</p>	<p>from other reliable sources.</p> <p>6. The above provisions shall not prevent the Ministry and the Commission from using the data referred to the preceding paragraphs of this Article as a reference if required for general information.</p>	<p>verifikuju iz drugih pouzdanih izvora.</p> <p>6. Gore navedene odredbe neće sprečiti Ministarstvo i Komisiju da koriste podatke iz prethodnih stavova ovog člana, kao referencu, ako je potrebno za opšte informacije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 25</p>	<p style="text-align: center;">Article 25</p>	<p style="text-align: center;">Član 25</p>
<p>1. Me qëllim të sigurimit të kualitetit, përmbajtes së produkteve që importohen dhe prodhohen brenda Kosovës, para futjes në tregun e Kosovës Ministria do të krijoj kushtet e pershtashme për testimin e përgjithshëm teknik të konfirmimit të produkteve.</p> <p>2. Ministria nëpërmjet laboratorëve shtetëror ose permes aplikimit të praktikave më të mira dhe transparente do të autorizoi kompani të certikuara laboratorike që të kryjnë këto testime të konformitetit të gjitha produkteve që hyjnë dhe janë në shtije në tregun e Kosovës</p>	<p>1. In order to ensure the quality and content of the products imported and produced within Kosovo, before entering the Kosovo market, the Ministry will create the appropriate conditions for the overall technical testing of the products' confirmation.</p> <p>2. The Ministry through state laboratories or through the application of best and transparent practices will authorize certified laboratory companies to carry out these conformity testing of all products entering and in the market in Kosovo</p>	<p>1. Da bi se osiguralo kvalitet i sadržaj proizvoda koji su uvezeni i proizvedeni na Kosovu, pre ulaska na tržište Kosova, Ministarstvo će stvoriti odgovarajuće uslove za cjelokupno tehničko ispitivanje potvrde proizvoda.</p> <p>2. Ministarstvo preko državnih laboratorija ili putem primjene najboljih i transparentnih praksi ovlastiti će sertifikovane laboratorijske kompanije da sprovedu ovo ispitivanje usaglašenosti svih proizvoda koji ulaze i na tržište na tržištu Kosova</p>
<p style="text-align: center;">Neni 26 Dispozitat përjashtuese</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Exclusive provisions</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Odredbe isključivanja</p>
<p>1. Ky ligj nuk pengon zbatimin e:</p> <p>1.1. ndalimeve, kufizimeve apo kontrolleve sasiore për importet, në mbështetje të legjislacionit në fuqi në mbrojtje të rregullit dhe</p>	<p>1. This Law does not prevent the application of:</p> <p>1.1. prohibitions or restrictions of quantity controls of imports, in support of legislation public order and safety; health protection and</p>	<p>1. Ovaj zakon ne sprečava primenu:</p> <p>1.1. zabrane, ograničenja ili kvantitativne kontrole uvoza, u podršci zakonodavstva na snazi za zaštitu javnog reda i bezbednosti,</p>

<p>të sigurisë publike, në mbrojtje të shëndetit dhe të jetës së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, në mbrojtje të pasurisë kombëtare, me vlera artistike, historike dhe arkeologjike, ose në mbrojtje të pronësisë, industriale dhe tregtare;</p> <p>1.2. veprimeve për këmbimin e monedhës së huaj;</p> <p>1.3. detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare;</p> <p>1.4. akteve ligjore dhe nënligjore për importet, si dhe të ligjeve të tjera për importet, kur nuk bien ndesh me këtë ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 27 Procedura e shqyrtimit gjyqësor</p> <p>Çdo palë e interesuar që ka marrë pjesë në një procedurë hetimi, apo që i'u ka refuzuar kërkesa, apo rishikimi të kryer nga Ministria dhe Komisioni ka të drejtë të paraqesë ankesë në Gjykatën kompetente me të cilën kërkon nga gjykata rishikimin e një veprimi ose vendimi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ankesa duhet të dorëzohet brenda dyzet e pesë (45) ditësh kalendarike pas pranimit nga pala e interesuar të njoftimit për veprimin ose vendimin përkatës.</p>	<p>protection of human life, animals and plants, protection of artistic, historic property and archaeological value or the protection of intellectual, industrial and commercial property;</p> <p>1.2. actions regarding the exchange of foreign currencies;</p> <p>1.3. obligations arising from international treaties;</p> <p>1.4. laws and bylaws on imports and other legislation related to imports that are not inconsistent with this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 27 Court review procedure</p> <p>Any interested party who has participated in an investigation procedure or to whom the request has been refused, or the review carried out by the Ministry and the Commission has the right to appeal to the Supreme Court, which requires the court to review an action or the decision of the Government of the Republic of Kosovo. The appeal must be filed within forty-five (45) calendar days after receipt by the interested party notice of such action or decision.</p>	<p>zaštite zdravlja i zaštite ljudskih života, životinja i biljaka, zaštite nacionalnog bogatstva, zaštite umetničke imovine, istorijske i arheološke vrednosti ili zaštite intelektualne svojine, industrijske i komercijalne;</p> <p>1.2. radnje u vezi razmene stranih valuta;</p> <p>1.3. obaveze koje proističu iz međunarodnih ugovora;</p> <p>1.4. zakonskih i podzakonskih akata o uvozu, kao i drugih zakona koji se tiču uvoza koji nisu u suprotnosti sa ovim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 27 Procedura sudskog razmatranja</p> <p>Svaka zainteresovana strana koja je učestvovala u istražnom postupku, ili kojoj je odbijen zahtev, odnosno revizija koju je izvršilo Ministarstvo i Komisija ima pravo na žalbu Vrhovnom Sudu, kojom se od suda zahteva razmatranje radnje ili odluke Vlade Republike Kosova. Žalbe se mora podneti u roku od četrdeset i pet (45) kalendarskih dana nakon prijema obaveštenja o radnji ili odluci od strane zainteresovane stranke.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 28 Dispozita kalimtare</p> <p>Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij ligji do të nxjerr akte nënligjore në afat prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 29 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <p style="text-align: center;">_____</p> <p>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p style="text-align: center;">Article 28 Transitional provisions</p> <p>For purposes of enforcement of this Law, the Ministry of Trade and Industry shall issue a bylaw within one (1) year from the date of entry into force of this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 29 Entry into force</p> <p>This law shall enter into force fifteen (15) days after its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <p style="text-align: center;">_____</p> <p>Assembly President of the Republic of Kosovo</p>	<p style="text-align: center;">Član 28 Prelazne odredbe</p> <p>Ministarstvo Trgovine i Industrije za sprovođenje ovog zakona donosi podzakonske akte u roku od jedne (1) godine od dana stupanja na snagu ovog zakona</p> <p style="text-align: center;">Član 29 Stupanje na snagu</p> <p>Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u Službenom Listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <p style="text-align: center;">_____</p> <p>Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>
---	---	--